

Konferenca “Rishikimi i Shpenzimeve Buxhetore si një mjet për të forcuar qeverisjen fiskale” organizuar nga Banka Botërore në Vjenë

Në datat 3 –4 prill 2024, në Vjenë, u zhvillua konferenca me temë “*Rishikimi i Shpenzimeve Buxhetore si një mjet për të forcuar qeverisjen fiskale*”, organizuar nga Banka Botërore me përfaqësues të Ministrive të Financave dhe Zyrave të Auditimit Shtetëror nga Ballkani Perëndimor. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit për mbështetjen e rajonit në forcimin e kornizave institucionale për politikën fiskale, me mbështetjen e Fondit të Mirëbesimit të Bashkimit Evropian për Forcimin e Qeverisjes Fiskale në Vendet e Ballkanit Perëndimor.

Konferenca u përshendet nga zyrtarë të zyrës rajonale të Bankës Botërore, përfaqësues të Komisionit Evropian, OECD ku ndër të tjera ndanë dhe eksperiencat tyre në implementimin e këtij mjeti dhe efektivitetin e tij në përmirësimin e planifikimit buxhetor, rritjen e llogaridhënies dhe transparencës.

Konferenca vijoi me prezantime të vendeve përfaqësuese të Bashkimit Evropian si Spanja, Danimarka, Hollanda, Sllovenia dhe Estonia, të cilët shkëmbyen njohuritë mbi qasjet praktike për hartimin dhe zbatimin e procesit të rishikimeve të shpenzimeve. Ata theksuan domosdoshmërinë e mëshitetjes së liderhipit politik si dhe pjesmarrjes së ekspertëve nga organizata profesionale, të shoqërisë civile dhe akademike në procesin e rishikimit të shpenzimeve buxhetore; periodicitetin e kryjes së këtij procesi si dhe rëndësinë e integritimit me procesin e buxhetimit vjetor, të planit buxhetor afatmesëm por edhe atë të vlerësimit të performancës të programeve buxhetore.



Dita e dytë vijoi me një panel përfaqësues të Ministrive të Financës së Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, ku vecanërisht kjo e fundit prezantoi kornizën rregullatore, sfidat e hasura në implementimin e rishikimeve të shpenzimeve buxhetore si dhe përfshirjen e ekspertëve nga auditimi i brendshëm, këshilli fiskal apo academia.

Në konkluzion, rishikimet e shpenzimeve nxisin transparencën dhe llogaridhënien dhe u mundësojnë qeverive të marrin vendime më të informuara në lidhje me alokimet buxhetore duke çuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe rezultate më të mira për qytetarët.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë konferencë nga znj. Valbona Gaxha, Këshilltare dhe znj. Anila Alcani, Përgjegjëse Sektori.